

VENDIM
Nr. 884, datë 27.12.2022

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2023, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

(Ndryshuar me VKm nr. 599, datë 18.10.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2023, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën *65 093 460 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë)* lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Aneksi nr. 1

PLANI I RISHIKUAR I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023

(Zëvendësuar me VKM nr. 599, datë 18.10.2023)

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2023 (lek)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	42,536,460
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6,825,730
3	Shërbime e furniturë	15,231,270
4	Investime	500,000
TOTALI		65,093,460